



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2021:049805

Datë: 02.12.2022

Numri i dokumentit: 03708531

PKR Nr. 155/21

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË, Departamenti i Krimeve të Rënda**, Kryetari i trupit gjykues Murat Hulaj, me anëtarët e trupit gjykues, gjyqtarët profesioniste Arben Mustafaj dhe Leon Përlaska, me pjesëmarrjen e zyrtarit ligjor Alan Taranish, në çështjen penale kundër të pandehurve I.H nga M., për shkak të veprës penale, **“Blerja, posedimi, shpërndarja apo shitja e paautorizuar e narkotikeve, substancave psikotrope apo analoge”**, nga neni 267 par. 1, të KPRK-së, dhe V.M, për shkak të veprës penale, **“Posedimi i paautorizuar i narkotikeve, substancave psikotrope apo analoge”**, nga neni 269 par. 1, të KPRK-së, e sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë, nen shenjen PP/I Nr. 76/2021 dt. 26.05.2021, pas mbajtjes dhe përfundimit të rigjyimit të shqyrtimit kryesor, të mbajtur me dt. 18.11.2022, si dhe pas mbajtjes dhe përfundimit të seancës për këshillim dhe votim, të njëjtën ditë me dt. 18.11.2022, morri dhe publikisht shpalli, ndërsa, me dt. 02.12.2022, përpiloi këtë:

**A K T G J Y K I M**

**Të akuzuarit:**

**V.M**, i biri i R. dhe nënës M., i lindur me dt. ..., ne P, me banim ne Rr. “ B.B. “, kati i . numër ., nuk posedon nr. të telefonit, me nr. personal ....., i shkurorëzuar, baba i një fëmije, i gjendjes se mesme ekonomike, shtetas i R. së Kosovës, ka qenë në paraburgim nga dt.12.03.2021 deri me 11.06.2021, tani mbrohet në liri,

**I.H**, i biri i O. dhe nënës M., i lindur me dt. ..., ne fsh. M. S., me banim ne M/, Rr. “ M. T.”, pn. i identifikuar me nr. personal ..., posedon telefon me nr. ...-.-..., i martuar, baba i një fëmije, me profesion mjeshtrë i fasadës, tani punoj ne një pastičeri time A. C. në Rr. “M. T.”, i gjendjes se mesme ekonomike, shqiptar shtetas i R. se Kosovës, ka qenë në paraburgim nga dt.12.03.2021 deri me 11.06.2021, tani mbrohet në liri,

**JANË FAJTOR**

## Sepse:

I pandehuri **V.M**,

- Më dt. 12.03.2021, rreth orës 16:15, min në Rr. "B. B.", K-P., e pikërisht në banesën e tij, pa autorizim posedon substanca narkotike të llojit marihuanë dhe atë në peshë të përgjithshme prej 9.6 gr, në atë mënyrë që ditën kritike policia e Kosovës-DHTN-së, e kanë bastisur-kontrolluar banesën e të pandehurit të lartcekur dhe në dhomën e fjetjes të tij, policia kanë gjetur substancën narkotike marihuanë dhe të njëjtën e kanë konfiskuar,
- me çka ka kryer veprë penale, "**Posedim i paautorizuar i narkotikeve, substancave psikotrope ose analoge**", nga neni 269, par. 1, të KPRK-së,

I pandehuri **I.H**,

- Më dt.12.03.2021, rreth orës 15:15 min ne P, e pikërisht tek rrethi D. M., pa autorizim e me qëllim të shitjes, ka poseduar substanca narkotike të llojit heroinë, në atë mënyrë që, policia gjatë patrullimit në lagjen F.kanë vërejtur një veturë C. C. me ngjyre të hirit, me targa ...-...-..., të cilën veturë ishte duke e drejtuar i pandehuri V., dhe për shkak të lëvizjeve të dyshimta hetuesit e DHTN-së e përcjellin veturën në fjalë dhe me të arritur afër marketit D. në Pejë, aty ndalon i pandehuri V. ku në veturën e tij hyn i pandehuri I., dhe nisen në drejtim të qytetit, por prapë kthehen te marketi D. dhe aty shkëmbejnë diçka mes vete, ashtu që hetuesit me të vërejt këtë veprim i afrohen veturës me qëllim të verifikimit se çka është duke ndodhur dhe gjatë kontrollit trupor tek i pandehuri I. H. në çorap i gjejnë një qese plasmasi ku në brendi të kësaj qese ishin të vendosura 7 qese të vogla të mbushura me substanca të dyshuara narkotike, të cilat pas ekzaminimit kanë rezultuar të jenë të llojit heroin në peshë të përgjithshme prej 3.16 gram.
- me çka ka kryer veprë penale "**Blerja, posedimi, shitja, shpërndarja e pa autorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge**" nga neni 267 par. 1 të KPK-së.

Andaj, gjykata konform nenit 7, 8, 9, 10, 17, 21 38, 39, 40, 43, 46, 47, 48, 49, 50, 69, 70, 79 nenit 269 par.1 dhe par. 3, dhe nenit 267 par. 1 dhe par. 5 të KPRK-së, dhe neneve 365, 366, 453 dhe 454 të KPPRK-së të pandehurit V.M dhe I.H, i:

## G J Y K O N

### Të pandehurin V.M:

- I. Me dënim me gjobë në shumë prej shtatëqind (700) euro të cilin dënim i pandehuri ka për ta paguar në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh pasi që ky aktgjykim të behet i plotfuqishëm.
- II. Dhe me dënim me burg prej një (1) i cili dënim fare nuk ka për tu ekzekutuar nëse i pandehuri brenda periudhës dy (2) vjeçare nuk kryen veprë tjetër penale, duke iu llogaritur edhe koha e kaluar në paraburgim nga dt.12.03.2021 deri me 11.06.2021.

- III. Nëse i pandehuri dënimin me gjobe dështon, refuzon, apo nuk dëshiron ta paguan, i njëjti do ti zëvendësohet me dënim burgimi duke llogaritur çdo dite qëndrimi ne burg shumen nga njëzetë (20) euro te gjobës.
- IV. Nëse i pandehuri brenda periudhës së verifikimit kryen vepër tjetër penale, dënimi i shqiptuar me kusht do të revokohet dhe do të zëvendësohet me burgim efektiv.
- V. Ne dënimin e shqiptuar me burgim me kusht, te pandehurit i llogaritet edhe koha e kaluar ne paraburgim nga dt. 12.03.2021 e deri me 11.06.2021.
- VI. I pandehuri V.M lirohet nga paguarja e shpenzimeve të procedurës penale dhe taksës për kompensimin e viktimave të krimit ngase i njëjti ka pension te invalidit.
- VII. Konform nenit 269 par. 3, të KPRK-së, të njëjtit i shqiptohet edhe dënimi plotësues:

**KONFISKIMI I SENDIT - KONFISKOHET** substanca narkotike të llojit . dhe atë në peshë të përgjithshme prej 9.6 gr dhe e njëjta **URDHËROHET** qe te **SHKATËRROHET** menjëherë pas plotfuqishmërisë se aktgjykimit.

#### **Të pandehurin I.H:**

- VIII. Me dënim me gjobë në shumë prej 1000 (njëmijë) euro i cili dënim ka për tu paguar ne afat prej 60 ditësh pasi qe aktgjykimi te behet i plotfuqishëm.
- IX. Dhe dënim me burg ne kohëzgjatje prej 2 vitesh me kusht qe i pandehuri brenda periudhës 3 vjeçare nuk kryen vepër tjetër penale, e në të cilin dënim i llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim nga dt.12.03.2021 deri me 11.06.2021.
- X. Nëse i pandehuri dënimin me gjobe nuk e paguan i njëjti do ti zëvendësohet me dënim burgimi duke llogaritur çdo dite qëndrimi ne burg shumen nga 20 euro te gjobës.
- XI. Nëse i pandehuri brenda periudhës së verifikimit kryen vepër tjetër penale, dënimi i shqiptuar me kusht do të revokohet dhe do të zëvendësohet me burgim efektiv.
- XII. Ne dënimin e shqiptuar me burgim me kushte ndaj te pandehurit, llogaritet edhe koha e kaluar ne paraburgim nga dt. 12.03.2021 e deri me 11.06.2021.
- XIII. I pandehuri obligohet në pagimin e paushallit gjyqësor ne shumen prej 50 (pesëdhjetë) €, ndërsa ne emër te taksës për kompensimin e viktimave te krimit shumen prej 50 euro(pesëdhjetë) €, e te gjitha këto në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.
- XIV. Të pandehurit në kuptim të nenit 267 par. 5 të KPRK-së i shqiptohet edhe dënimi plotësues:

**KONFISKIMI I SENDIT - KONFISKOHET** substanca narkotike të llojit h. dhe atë në peshë të përgjithshme prej 3.16 gr dhe e njëjta **URDHËROHET** qe te **SHKATËRROHET** menjëherë pas plotfuqishmërisë se aktgjykimit.

## A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Pejë-Departamenti për Krime të Rënda ka ngrit aktakuzën nën shenjen PP/I.nr.76/2021, të dt. 26.05.2021, kundër të pandehurve V.M nga D. i akuzuar për veprë penale “Posedim i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge”, parashikuar nga neni 269 par.1 të KPRK-së dhe I.H nga P. i akuzuar për veprën penale, “Blerja, posedimi, shitja dhe shpërndarja e paautorizuar i narkotikeve, substancave psikotrope dhe analoge”, nga neni 267 par.1 i KPRK-së.

Konform nenit 245 të KPP-së, me dt. 11.06.2021, është mbajtur seanca e shqyrtimit fillestar, është konstatuar se prezentë kane qene Prokurorit të Shtetit, Valbona Disha Haxhosaj, te pandehurve V.M me mbrojtësin av. Gezim Kollçaku dhe I.H me mbrojtësin av. Sali Mekaj.

Në seancën e shqyrtimit fillestar të mbajtur me dt. 11.06.2021, gjykata fillimisht ka njoftuar të pandehurit me të drejtat dhe detyrimet e tyre ligjore. Në këtë seance, i pyetur për fajësinë apo pafajësinë, i pandehuri V.M, ka deklaruar se e pranon fajësinë për veprën penale për të cilën po akuzohet. Po ashtu, i pandehuri I.H, i pyetur për fajësinë apo pafajësinë, ka deklaruar se e pranon fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet.

Pas kësaj, gjykata me dt. 08.07.2021, ka marrë aktgjykim dënues ndaj të pandehurve, respektivisht ndaj të pandehurit V.M, për veprë penale, **“Posedim i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge”**, parashikuar nga neni 269 par.1 të KPRK-së, dhe ndaj të pandehurit I.H, për veprën penale, **“Blerja, posedimi, shitja dhe shpërndarja e paautorizuar i narkotikeve, substancave psikotrope dhe analoge”**, nga neni 267 par.1, i KPRK-së.

Gjykata e Apelit në Prishtinë, duke vendosur përkitazi me ankesën e mbrojtësit të akuzuarit I.H, av. Salih Mekaj, e paraqitur kundër aktgjykimit nën shenjen PKR 100/21 te datës 08.07.2021, me datën 15.09.2021, ka marrë Aktvendim nën shenjen PAKR Nr. 343/21, me të cilin aktgjykimi i shkallës së parë është anuluar, dhe çështja është kthyer në rigjykim dhe rivendosje.

Gjykata Themelore në Pejë, me dt. 18.11.2022, ka caktuar dhe mbajtur seancën se shqyrtimit kryesor gjyqësor në këtë çështje penale, në të cilën seance kanë qenë të pranishëm Prokurorja e Shtetit nga Prokuroria Themelore në Pejë, i pandehuri V.M, dhe i pandehurit I.H.

Të pandehurit secili veç e veç, në fillimin e rishqyrtimit kryesor prapë janë njoftuar me të drejtat dhe detyrimet e tyre sipas ligjit, e konform nenit 323 të KPPRK-së.

I pandehuri V.M, i pyetur për mbrojtësin, ka deklaruar se nuk ka angazhuar mbrojtës, nuk ka nevojë për të njëjtin dhe se mbrojtjen do të jep personalisht.

Po ashtu, i pandehuri I.H, i pyetur për mbrojtësin, ka deklaruar se nuk ka angazhuar mbrojtës, nuk ka nevojë për të njëjtin dhe se mbrojtjen do të jep personalisht.

Të pandehurit secili veç e veç, në lidhje me leximin e aktakuzës kanë deklaruar se të njëjtën e kanë kuptuar, e dijë për çka po akuzohen dhe se nuk ka nevojë që e njëjta të lexohet, heqin dore nga leximi i saj, ashtu që trupi gjykues ka marrë aktvendim procedural me të cilin ka konstatuar si të lexuar aktakuzën e Prokurorisë Themelore në Pejë – Departamenti i Krimeve të Rënda, nën shenjen PP/I Nr. 76/2021 dt. 26.05.2021.

Pas kësaj, gjykata të pandehurve ju ka shpjeguar kushtet, privilegjet dhe pasojat e pranimit të fajësisë, sipas nenit 248 par. 1 pika 1.1, - 1.4, të KPPRK-së, dhe pasi që gjykata është bindur se të njëjtit e kanë kuptuar të drejtat e tyre ligjore, konform nenit 325 të KPPRK-së, të pandehurve ju ka dhënë mundësinë që të deklarohen për fajësinë apo pafajësinë në fillim të shqyrtimit kryesor.

I pandehuri I.H, në lidhje me fajësinë apo pafajësinë ka deklaruar së: *e pranoj fajësinë për këtë veprë penale, për veprën penale, "Blerja, posedimi shpërndarja apo shitja e narkotikeve substancave psikotrope apo analoge" nga neni 267 par.1, të KPRK-së që me ngarkohet sipas aktakuzës, me vjen keq që ka ndodhur.*

I pandehuri V.M, i pyetur për fajësinë apo pafajësinë ka deklaruar së: *e pranoj fajësinë për këtë veprë penale, për veprën penale, "Posedimi i paautorizuar narkotikeve substancave psikotrope apo analoge", nga neni 269 par. 1, të KPRK-së, që me ngarkohet sipas aktakuzës, me vjen keq që ka ndodhur.*

Prokurorja e Shtetit në lidhje me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarve në fillim të shqyrtimit kryesor ka deklaruar së: *pajtohem me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarve I.H dhe V.M, për veprat penale për të cilat akuzohen sipas aktakuzës, meqenëse pranimi i tyre i fajësisë plotëson kushtet ligjore dhe është në përputhje edhe me provat ne baze të se cilave është ngrit aktakuza andaj i propozoj gjykatës që ta aprovoj pranimin e tyre të fajësisë.*

Në vijim gjykata duke shqyrtuar pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarve V.M dhe I.H, ka gjetur se pranimi i tyre i fajësisë për veprat penale për të cilat akuzohem paraqet shprehje të lirë të vullnetit të akuzuarve secilit veç e veç, së të njëjtit e kanë kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, se pranimi i fajësisë gjen mbështetje edhe ne provat që gjenden në shkresat e lëndës dhe po ashtu është bërë konform dispozitave përkatëse ligjore, nga neni 248 par. 1 nën par. 1.1 e gjerë në 1.4 e lidhur me nenin 326 të KPPRK-së.

Duke pasur parasysh të lartcekurat, trupi gjykues me Aktvendim procedural e ka aprovuar pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarve, V.M dhe I.H, ngasë pranimi i tyre i fajësisë gjen mbështetje edhe në provat vijuese të cilat gjenden të bashkangjitura në shkresa të lëndës: *Raporti i oficerit A. R., i dt.12.03.2021, raporti informues i dt.12.03.2021, deklarata e të pandehurit V.M, e dhënë në polici me dt.12.03.2021, dhe në prokurori me dt.06.04.2021, librezë për realizuesin e së drejtës në pension e personave me aftësi të kufizuar, vërtetimi mbi sekuestrimin e përkohshëm të sendeve i dt.12.03.2021, procesverbali për kontrollë dhe sekuestrim të përkohshëm të dt.12.03.2021, skica e objekteve të kontrolluara, informacionet e personit të dyshuar V.M, deklarata e të pandehurit I.H, e dhënë në polici me dt.12.03.2021, dhe ne prokurori me dt.06.04.2021, ekzaminimi mjekësorë në emër të I.H, vërtetimi mbi sekuestrimin e përkohshëm të sendeve të dt.11.03.2021, procesverbali për kontroll dhe sekuestrim të përkohshëm i dt.12.03.2021, skica e objekteve të kontrolluara, informacionet e personit të dyshuar I.Ht, raporti i analizës së narkotikëve i dt.12.03.2021, raporti i ekspertimit i dt.08.04.2021, raporti i analizës së narkotikëve i dt.25.03.2021, raporti informues i dt.19.03.2021, raporti i këqyrjes së vendit të ngjarjes i dt.12.03.2021, raporti i ekzaminimit të telefonave me nr.AKF-.....-..... dt.26.04.2021, foto dokumentacioni si dhe të administrohen shkresat e tjera të lëndës, dhe mbi këtë është vërtetuar përtej dyshimit të bazuar mirë, se të akuzuarit e kanë kryer veprat penale të cilat i vihen në barrë, si dhe faktin se janë plotësuar kushtet nga neni 248 par. 1, nën par. 1.1, e gjerë në 1.4, të KPPRK-së, atëherë ne këtë çështje penale nuk është zbatuar procedura e provave, por gjykata pas deklarimit të akuzuarve se e pranojnë fajësinë në kuptim të nenit 326 par. 4 të KPPRK-së ka vazhduar me fjalën përfundimtare dhe shqiptimin e dënimit.*

Prokurorja e Shtetit, në fjalën përfundimtare ka deklaruar së: *meqenëse të akuzuarit secili veç e veç e kanë pranuar veprat penale për të cilën janë akuzuar, unë në tërësi mbes pranë përshkrimit faktik dhe juridik të veprave penale dhe kërkoj nga gjykata që të njëjtit të shpall fajtor, të dënon sipas ligjit si dhe ta obligohen ne paguarjen e shpenzimeve të procedurës penale. Po ashtu i propozoj gjykatës që konform nenit 267 par. 5, dhe nenit 269 par.3, substancat narkotike e cila ka qenë objekt i kryerjes se veprës penale të konfiskohet dhe për të njëjtat të lëshohet urdhri për shkatërrim.*

*Me rastin e vendosjes lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit, i propozoj gjykata që si rrethana lehtësuese për të dy të akuzuarit të vlerëson pranimin e fajësisë, kurse si rrethana rënduese për të pandehurin V.M, faktin se, i njëjti më parë ka qenë i dënuar me aktgjykimet P.nr.709/08, P.nr. 209/13, dhe P.nr. 339/19, rrethane tjetër nuk kam gjetur për të pandehurin V., kurse si rrethana rënduese për të pandehurin I.t, gjykata të vlerëson motivin e kryerjes së kësaj vepre, i cili ka qenë përfitimi i kundërligjshëm, rrezikshmëria e kësaj vepre penale si dhe pasojat që shkaktohen të personat të cilat blejnë dhe konsumojnë substancat narkotike*

I pandehuri I.H, në fjalën përfundimtare ka deklaruar: *me vjen keq që ka ndodhur, jam penduar shumë, i premtoj gjykatës që nuk do ta përsëris veprimet e tilla në të ardhmen, i kërkoj gjykatës që të me shqiptojë një dënim sa më të butë.*

I pandehuri V.M në fjalën përfundimtare ka deklaruar: *me vjen keq që ka ndodhur, jam penduar shumë, i premtoj gjykatës që nuk do ta përsëris veprimet e tilla në të ardhmen, unë kam qenë konsumues i kësaj substancës, tani jam dukshëm i përmirësuar pasi që nuk e konsumoj më, i kërkoj gjykatës që të me shqiptojë një dënim sa më të butë.*

Me faktet e ofruara në shkresat e lëndës, si dhe me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurve është vërtetuar gjendja faktike si në dispozitiv I dhe II të këtij aktgjykimi. Nga gjendja e vërtetuar faktike si është përshkruar në dispozitiv I dhe II të aktakuzës, pa dyshim rrjedh se në veprimet e të pandehurit V.M qëndrojnë të gjitha elementet e veprës penale “Posedim i paautorizuar i narkotikeve, substancave psikotrope ose analoge” nga neni 269, par. 1 të KPRK-së, ndërsa në veprimet e të pandehurit I.H qëndrojnë të gjitha elementet e veprës penale “Posedimi, shitja, shpërndarja e pa autorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge” nga neni 267 par. 1, të KPK-së.

Sa i përket fajësisë, gjykata ka gjetur se tek të akuzuarit ka ekzistuar dashja që veprat penale ta kryejnë në mënyrë të përshkruar si në dispozitiv I dhe II të aktgjykimit, pasi që të njëjtit kanë qenë të vetëdijshëm për veprat e kryera dhe e kanë dëshiruar kryerjen e tyre.

Gjatë procedurës penale nuk janë paraqit rrethana të cilat do ta zvogëlojnë apo përjashtojnë përgjegjësinë penale të pandehurve, kështu që të njëjtit janë penalisht përgjegjës.

Trupi gjykues në aplikim të neneve 69 dhe 70 të KPRK-së, i vlerësoi rrethanat lehtësuese dhe rënduese të përcaktuara e të përmendura nga ana e palëve në procedure gjatë seancës të cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit ashtu që si rrethana lehtësuese për të pandehurin **V.M** gjeti pranimin e fajësisë në mënyrë të vullnetshme, pendimin e tij, për veprën e kryer, ndërsa si rrethana rënduese për të njëjtin gjykata gjeti së i njëjti edhe më parë ka qenë i dënuar dhe atë me aktgjykimet P.nr.709/08, P.nr. 209/13, dhe P.nr. 339/19, ndërsa në raport me të pandehurin **I.H**, gjykata si rrethana lehtësuese gjeti pranimin e tij të vullnetshëm të fajësisë, pendimin e shprehur për veprën penale e kryer, kurse si rrethana rënduese gjeti motivin e kryerjes së veprës penale i

cili është përfitimi i kundërligjshëm pasuror me kryerjen e kësaj veprë penale, rrezikshmërinë shoqërore e veprave penale të cilat kanë të bëjnë me shitjen e narkotikeve, si dhe pasojat që shkaktohen tek personat të cilat blejnë dhe konsumojnë substancat narkotikë.

Andaj gjykata duke u gjendur para këtyre rrethanave të akuzuarit e gjykoi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke konsideruar se këto dënime janë në përputhje me shkallën e përgjegjësisë penale të tyre dhe me intensitetin e rrezikimit të vlerave të mbrojtura të shoqërisë dhe është bindur se, vendimi mbi dënimin do të shërbej për arritjen e qëllimit të dënimit e që është pengimi i të akuzuarit në kryerjen e veprave penale në të ardhmen si dhe në preventivën tjetër për personat tjerë që të përmbahen nga kryerja e veprave penale konform nenit 38 të KRPK-së.

Andaj, gjykata në kuptim të nenit 43 e lidhur me nenin 267 par. 1, dhe 269 par. 1, të KRPK-së, të pandehurve ju shqiptoi dënimet me gjobë si në pikat I dhe VII të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Konform dispozitave ligjore të neneve, 46, 47, 48, 49 dhe 50 e lidhur me nenin 267 par. 1, dhe 269 par. 1, të KRPK-së, gjykata të pandehurve ju shqiptoi dënimet e kushtëzuara si në pikat II dhe VIII, të diapozitivit të këtij aktgjykimi.

Vendimi për zëvendësimin e dënimit me gjobë në burgim është marrë konform nenit 43 par. 3 të KRPK-së nëse të pandehurit dështojnë, refuzojnë apo nuk paguajnë dënimet e shqiptuara me gjobë.

Vendimi për revokimin e dënimeve të shqiptuara me kusht dhe zëvendësimin e tyre në burgim efektiv nëse të pandehurit kryejnë vepra tjera penale brenda periudhës së verifikimit është marrë konform nenit 50 të KRPK-së.

Vendimi për llogaritjen e kohës së kaluar në paraburgim në dënimin e shqiptuar me kusht është marrë konform nenit 79 par. 1 të KRPK-së.

Vendimi për lirimin e të pandehurit V.M nga paguarja e shpenzimeve të procedurës penale, është marrë konform nenit 453 par. 4, të KPPRK-së, pasi që i njëjti merr pensionin e invalidit.

Në raport me të pandehurin I.H, vendimi për paguarjen e shpenzimeve procedurale u morr konform nenit 450 par. 1, par.2, nën pika 2.6, të KPPRK-së, ndërsa, vendimi për taksat e kompensimit të viktimave të krimit, u morr në bazë të qarkores për zbatimin e ligjit NR.05/L-36.

Vendimi për shqiptimin e dënimeve plotësuese, respektivisht konfiskimin e sendeve (narkotikëve) të cilat kanë qenë objekt i kryerjes së veprave penale, është marrë konform dispozitave ligjore të nenit 267 par. 5 dhe 269 par. 3, të KRPK-së.

Nga sa u tha më lart u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi konform nenit 365 të KPPRK-së.

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË**  
**DEPARTAMENTI I KRIMEVE TË RËNDA**  
**PKR Nr. 155/21 dt. 02.12.2022**

**Zyrtari ligjor**

**Kryetari i trupit gjykues,**

---

**Alan Taranish**

---

**Murat Hulaj**

**KËSHILLË JURIDIKE:**

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet të kësaj gjykate.